

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS- koleji i përbërë nga gjyqtarët: Emine Kaçiku, kryetare, Shukri Sylejmani dhe Gyltene Sylejmani, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit S. B. nga Lipjani të cilin e përfaqëson N. G. avokat në Lipjan, kundër të paditurit A. K. nga Lipjani të cilin e përfaqëson F. B., avokat nga Ferizaj, për shkak të vërtetimit të pronësisë, përkitazi me revizionin e të paditurit paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.4471/2016 datë 19.12.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur më 21.8.2017, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pabazuar revizioni i të paditurit paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.4471/2016 datë 19.12.2016.

A r s y e t i m i

Me pjesën I të dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.4471/2016 datë 19.12.2016, është pranuar ankesa e të autorizuarit të paditësit S.B., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore Prishtinë-Dega në Lipjan, C.nr.280/2013 datë 20.7.2016, në pjesën që ka të bëjë me shpenzimet e procedurës kontestimore është ndryshuar dhe gjykuar si në vijim: me pjesën II. të dispozitivit është detyruar i padituri A. K., nga Lipjani që paditësit S. B. nga Lipjani në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore t'ia paguajë dhe atë: për përpilim të padisë shumë prej 104 €, për përpilimin e një parashtrese shumë prej 104 €, për përfaqësinë në pesë seanca të mbajtura shumë prej 135,20 €, për secilën seancë, për ekspertizë të gjeodezisë shumë prej 100 €, për taksë gjyqësore për padi shumë prej 26 € dhe për

aktgjykim shumë prej 26 €, e që gjithsejtë përbëjnë shumë prej 1.036 €, kurse pjesa tjetër e aktgjykimit mbetet e pandryshuar. Me pjesën III. të dispozitivit është refuzuar si e pabazuar ankesa e të autorizuarit të paditurit, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore Prishtinë-Dega në Lipjan, C.nr.280/2013 datë 20.7.2016, me ndryshimet e mësipërme është vërtetuar, me të cilin është aprovuar si e bazuar kërkesëpapia e paditësit dhe është vërtetuar se paditësi e ka fituar të drejtën e pronësisë mbi bazën e posedimit të ligjshëm dhe me mirëbesim të sipërfaqes prej 84 m², të ngastrës 1450-14 tani në pronësi të paditurit A. K., e që evidentohet në ZK Lipjan, dhe e cila matet dhe përkufizohet në pjesën perëndimore në rrugën publike pasuri shoqërore ngastra 1593-0, në gjërsi prej 2.55 m, në pjesën veriore përkufizohet me pjesën e mbetur të parcelës amë 1450-14 në pronësi të paditurit në gjatësi prej 17,65 m, në pjesën lindore kufizohet me ngastrën kadastrale nr. ..., në pronësi të paditësit në gjatësi prej 6.82 m, dhe në pjesën jugore kufizohet me ngastrën nr. ..., në gjatësi prej 18.48 m, e regjistruar si pasuri shoqërore e ujërave dhe është detyruar i padituri që këtë sipërfaqe t'ia njeh të drejtën e pronësisë paditësit dhe të lejojë në regjistrimin e regjistrave të paluajtshmërive, në të kundërtën kjo e drejtë do të regjistrohet në bazë të këtij aktgjykimi si titull juridik. Me pjesën IV të dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë është refuzuar si e pabazuar ankesa e të autorizuarit të paditësit ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore Prishtinë- Dega në Lipjan, C.nr.280/2013 datë 20.7.2016, është vërtetuar.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë i padituri me kohë ka paraqitur revizion për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikimit jo të drejtë të dispozitave materiale, me propozim që aktgjykimi i kundërshtuar dhe ai i gjykatës së shkallës së parë të prishen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

Paditësi ka paraqitur përgjigje në revizion me të cilën propozon që revizioni të hedhet si i palejuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur sipas nenit 215 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Revizioni është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës del se paraardhësi i paditësit-babai H. B., si blerës, me shitësin S. K., ka lidhur kontratë me shkrim, në prani të dëshmitarit, e pa vërtetuar në gjykatë, për shitblerjen e pjesës së parcelës nr..., për rrugë në gjerësi prej 4 m, dhe gjatësi 16 m, për çmimin prej 2.000 DM, të cilën shumë blerësi e ka paguar ditën e përpilimit të kontratës dhe menjëherë ka hyrë në posedim. Paluajtshmërinë e cekur S. K., e ka blerë nga E. M., por nuk kanë përpiluar kontratë me shkrim, ndërsa më vonë parcelën nr.1450-14 S. K., ia shet të paditurit A. K.. Parcela kontestuese ka qenë e evidentuar në emirin e E. M., e cila ka lidhur kontratë me A. K., për shitblerjen e patundshmërisë së cekur, për t'ia mundësuar këtu të paditurit regjistrimin në librat kadastrale (duke përfshirë edhe pjesën e parcelës të cilën më parë paraardhësi i paditësit e ka blerë nga S. K., për rrugë), e të cilën kontratë e kanë vërtetuar në Gjykatën Komunale në Lipjan, Vr.nr.... datë 26.07.2006. Me aktvendimin nr. 9-464-2518 datë 1.3.2012, parcela kadastrale nr.P-..., është regjistruar në emrin e të paditurit, pranë Drejtorisë për gjeodezi dhe kadastër në komunën e Lipjanit. Me aktvendimin T.nr.497/15 datë 24.6.2013, paditësi është shpallur trashëgimtar i tani të ndjerit H. B.. Nga gjendja faktike e konstatuar nga eksperti i gjeodezisë, paditësi ka bërë precizin e padisë, më afër të përshkruar si në dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata e shkallës së parë, në këtë gjendje të çështjes, ka gjetur se duke u bazuar në nenin 28 par.4 të LMTHJP, ligjit të aplikueshëm në kohën kur është krijuar marrëdhënia juridiko-civile, paditësi është pronar i pjesës kontestuese, pasi që i njëjti ishte në posedim me mirëbesim dhe të ligjshëm të paluajtshmërisë kontestuese të cilën e ka shfrytëzuar nga viti 1994, për nevojat e kalimit në arën e tij që gjendet në anën lindore nga pjesa kontestuese, pra kjo pjesë shfrytëzohej si rrugë dhe për këtë qëllim ishte blerë nga paraardhësi i paditësit, pastaj ka vendosur si në dispozitivin e atij aktgjykimit.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore ka vlerësuar se pretendimet e paditësit të cekura në ankesë lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore, janë të bazuara dhe duke vlerësuar se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të gabuar ka zbatuar nenin 450 të LPK, në këtë pjesë ka ndryshuar aktgjykimin si në pjesën II të dispozitivit, ndërsa për pjesën tjetër të aktgjykimit ka vlerësuar se nuk është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës

kontestimore dhe pretendimet e të paditurit i ka vlerësuar si të pabazuara e pa ndonjë mbështetje në prova konkrete.

Gjykata Supreme e Kosovës gjen se është i drejtë dhe i ligjshëm qëndrimi juridik dhe arsyetimi i gjykatës së shkallës së dytë lidhur me refuzimin e ankesës së të autorizuarit të paditurit dhe vërtetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë. Aktgjykimi i goditur është i qartë dhe konkret, nuk përmban kundërthënie qoftë me vetveten ose me arsyetimin. Në arsyetimin e tij janë dhënë arsye të duhura faktike dhe juridike mbi të gjitha faktet juridikisht të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështjeje juridike, duke nxjerr konkludime të cilat në tërësi i aprovon edhe kjo gjykatë.

Pretendimin e cekur në revizion se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është marrë me shkeljet esenciale të dispozitës së nenit 182 par.1 e 2 pika (n) të LPK, për të cilat gjykata e shkallës së dytë është e obliguar që të kujdeset zyrtarisht, Gjykata Supreme e Kosovës, gjen se këto pretendime të revizionit nuk qëndrojnë, nga se gjykata e shkallës së dytë në arsyetimin e aktgjykimit ka dhënë arsye dhe shpjegime të hollësishme për këto pretendime të cilat janë paraqitur në ankesën kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë. Në revizion është cekur se gjykata e shkallës së dytë nuk i ka analizuar me vëmendje dhe nuk ka bërë çmuarjen e drejtë të provave, siç është paraparë me dispozitën e nenit 8 të LPK, por nuk është cekur asnjë pretendim për ndonjë provë konkrete, andaj kjo gjykatë një pretendim të tillë të paditurit e vlerësoi si të pabazuar.

Pretendimin e të paditurit se gjykatat e instancës më të ulët u kanë falë besimin vetëm dëshmitarëve të propozuar nga paditësi, dhe në këtë mënyrë kanë shkelur parimin e barazisë së armëve, e cila ka pas ndikim në marrjen e një vendimi të drejtë e të ligjshëm, Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi si të pabazuar, nga se sipas nenit 8 të LPK, gjykata vendos vet se cilat fakte do t'i konsideroj të provuara e cilat jo, në bazë të çmuarjes me ndërgjegje e të kujdesshme të provave dhe në bazë të rezultatit të gjithë procedimit.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, gjykatat e instancës më të ulët në mënyrë të drejtë kanë vlerësuar se gjen zbatimin neni 28 par.4 i LMTHJP, se paditësi ka fituar të drejtën e pronësisë mbi bazën e posedimit të ndërgjegjshëm dhe të ligjshëm të ngastrës lëndore, sepse është vërtetuar se paraardhësi i paditësit nga pronari faktik S. K., ka blerë pjesën e ngastrës 1450-

14 që shërben si rrugë për të kaluar në arën e tyre, për të cilën pjesë e ka paguar çmimin e shitblerjes dhe ka qenë në posedim të vazhdueshëm e me mirëbesim nga data kur është nënshkruar kontrata (e pa vërtetuar në gjykatë), më datë 31.1.1994 e gjer në kohën para ushtrimit të padisë kur i padituri ia mohon të drejtën e shfrytëzimit të kësaj pjese. I padituri gjatë procedurës nuk e ka mohuar faktin se ai vetë e ka ndërtuar murin i cili e ndan pjesën kontestuese nga pjesa e parcelës të cilën ai e ka në disponim, dhe paditësi e ka shfrytëzuar atë vend për qasje në arat e tij. Ndërsa, dëshmitarja e propozuar nga i padituri E. M., ka vërtetuar faktin se ngastrën kadastrale nr. ..., ia ka shitur S. K., dhe e njëjta me të paditurin A. K., ka lidhur kontratën e datës 26.7.2006, për t'ia mundësuar të paditurit bartjen e pronësisë në librat kadastrale. Andaj, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se pretendimet e revizionit lidhur me zbatimin e gabuar të drejtës materiale janë të pabazuara. Qëndrimin juridik të gjykatave të instancës më të ulët si të drejtë e të bazuar në ligj e aprovon edhe kjo gjykatë e revizionit.

Gjykata Supreme e Kosovës, shqyrtoi edhe pretendimet tjera të revizionit lidhur me kontratën e pa vërtetuar se ka qenë vetëm kontratë formale; se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është ekspeduar me kohë; se gjykata e shkallës së dytë lidhur me ankesat e paraqitura ka vendosur me prioritet në një afat kohor të përshpejtuar dhe jo objektiv, për ta favorizuar paditësin dhe dëmtuar palën e paditur, por këto pretendime nuk patën ndikim në ligjshmërinë e aktgjykimit dhe faktet që kjo gjykatë të vendos ndryshe, nga se janë vetëm vlerësim nga i padituri dhe nuk ka mbështetje në prova konkrete.

Nga sa u tha më lart e me zbatimin e nenit 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimit.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

Rev.nr.68/2017 datë 21.8.2017

Kryetare e kolegjit,

Emine Kaçiku